Gazeta e Prindit # 6

"Foleja e Shqiponjave" Mars, 2019

Ngjarjet e rëndësishme

Ditën e Djelë me 7 Prill, 2019, u organizua Analiza Vjetore e Bordit të shkollës "Foleja e Shqiponjave". Në këtë mbledhje u morën vendime të rëndësishme. Ishte i pranishëm edhe nën/kryetari i Bordit të Shoqatës. Z. Nebi Murseli.

Kaloi një vit që nga mbledhja e parë e bordit të shkollës. Në këtë analize vjetore u diskutuan arritjet dhe sukseset e "Folesë së Shqiponjave" gjatë vitit shkollor 2018-2019, dhe u morën vendime për një fillim te mbarë për vitin e ardhshëm.

Ky ishte Rendi i Ditës:

- Miratimi i raportit vjetor
- Buxheti i shkollës
- Kontributi i çdo antari të bordit (çfarë ka qenë kontributi personal si antar i bordit, fusha e ekperiences, lidhjet me familjet, organizatat, etj)
- Proçesi i zgjedhjes për bordin të ri për 2019-2020
- Veprimtaritë për muajt Maj-Qershor, në mënyrë të veçantë

a. Udhëtimi në Drumheller (e Shtunë, 1 Qershor për Festën e Fëmijëve)
~~a.~~b. Pikniku i fundit të vitit (e Shtunë, 29 Qershor Glenmore Park)

Në bazë të raportit financiar të përgatitur nga financierja e Shoqatës, Ilda Koço, rezulton se shkolla **ka mbuluar te gjitha shpenzimet e saj**, pa j'u "bërë barrë" Shoqatës. Ja një pasqyrë të ardhurave/shpenzime'

	Të Ardhura	**Shpenzime**	**Mbetje**
Semestri 1	$6960	$ 6909.57	$ 50.43
Semestri 2	$5250	$ 5160	$ 90

Mund të lexoni Raportin Vjetor dhe Raportin Financiar të plotë si attachment në e-mail që u është dërguar. Bordi i shkollës me votim transparent mori këto vendime :

- Të rritet bordi nga 5 në 11 antarë, me përfaqësues nga prindërit dhe të quhet « **Këshilli i Shkollës**»
- **Janë propozuar** si antarë për Këshillin e Shkollës : Gëzim Ugzmajli, Zoica Dhamo, Vjollca Guri, Adriana Bejko, Mira Mali, Danjela Lumani, Shqipe Kuqi, Arben Nexhi, Ermira Kusari, Zana Murseli, Kaltrina Kusari, Marigona Duraj

Vendimi përfundimtar dhe zgjedhjet për drejtimin e Bordit bëhen javën e fundit të Majit. Ju lutem n'a dërgoni mendimet apo verejtjet tuaja në adresën – 12dracana@gmail.com

JU FALENDEROJME PER MBESHTETJEN QE I JEPNI FEMIJEVE TANE!

"FOLEJA E SHQIPONJAVE" DIXHITALIZON MESIMIN

Përfshirja e teknologjisë në mësimdhënie është një domosdoshmëri në kohën që jetojmë. Ashtu si në të gjithë shkollat Kanadeze, edhe te "Foleja e Shqiponjave" ka filluar tashmë futja e teknologjisë në klasë. Janë filluar disa iniciativa të reja n ë mësimdhënje. E para, është futja e dy programeve të reja kompjuterike, Quizlet dhe Tarsia. Çdo të Shtunë, nxënësit punojnë me këto dy programe, ku praktikojnë dhe testojnë fjalët e reja të mësuara në klasë. Këto programe janë kaq tërheqëse dhe argëtuese sa nxënësit mezi presin ti përdorin. Po ashtu, fëmijëve së bashku me prindërit, iu është dhënë mundësia ti përdorin këto programe dhe në shtëpi. Kështu që kur vijnë në klasë javën tjetër i kanë fjalët e mësuara. Kjo ka sjellë një përmirësim të dukshëm në fjalorin e fëmijëve. Dhe gjëja më e rëndësishme është që fëmijët jo vetëm mësojnë por në të njëjtën kohë kalojnë kohën me prindërit.



Një iniciativë tjetër shumë e suksesëshme është dhe bashkëpunimi me partnerin tonë Best Buy. Është krijuar një traditë e bukur ku çdo të Shtunë të fundit të muajit, punonjës të Best Buy vijnë dhe organizojnë aktivitete të ndryshme me fëmijët. Por kjo e Shtunë ishte e vecantë nga të tjerat dhe fëmijët mezi e prisnin. Miqtë tanë të Best Buy sollën Goggles (VR) që fëmijët të argetohen me to. Me këtë rast, mësueset që më parë kishin kordinuar me Best Buy dhe kishin dërguar materialin që do të shfaqej në VR. Mikja jonë e Best Buy-it znj. Tracy bëri të mundur montazhin e pamjeve të dërguara. Disa muaj më parë, me rastin e Festës së Flamurit, nxënësit e shkollës krijuan postera me titullin "JAM SHQIPTAR", ku paraqitën pamje të qyteteve, viseve dhe kulturës shqiptare. Fëmijët prezantuan posterat e tyre. Ishte me të vërtetë prekëse dhe mahnitëse të shihje që fëmijët edhe pas 6 muajve mbanin mend dhe dinin të flisnin kaq bukur për çdo pamje të përfshirë në poster.

BRAVO FËMIJËVE TANË TË MREKULLUESHËM! Nxënësit u ndanë në grupe dhe patën rastin e mrekullueshëm të shohin në realitet virtual (virtual reality) viset tona të bukura shqiptare. Nuk kishte kenaqësi më të madhe të shihje fëmijët tanë kaq të gëzuar dhe të lumtur. Të gjitha këto experienca jo vetëm kënaqën fëmijët por edhe luajtën një rol të madh në përforcimin e njohurive të marra. Pra informacioni i marrë kaloi nga kujtesa afat-shkurtër në atë afat-gjatë. Ishte me të vërtetë një ditë e paharruar që do mbahet mend nga të gjithë ne, dhe vecanërisht nga fëmijët. Një falenderim i vecantë për Best Buy-in që bëri të mundur realizimin e këtij aktiviteti. Ja disa nga momentet:

ARGËTOHEMI DHE MËSOJMË SË BASHKU

Të dashur prinder, qëllimi kryesor i "Folesë së Shqiponjave" është mësimi i gjuhës dhe kulturës së kombit.Krahas kësaj, një pikësynim tjetër i shkollës sonë është ndërthurja e njohurive që marrin në shkollë me aktivitetet jashtë shkolle. Ky pikësynim u arrit më së miri përmes dy aktiviteteve që u zhvilluan më 23 Mars, vizita në Biblioteken Qëndrore Downtown, dhe 24 Mars vizita në Devonian Garden.

Biblioteka Qëndrore - Gjatë këtij aktiviteti, gjithçka shkoi siç u planifikua. Takimi u be tek hyrja e bibliotekes në orën 3 mbasdite. Të gjithë prinderit sollën Lejet e Prindit dhe Fletën e Anketimit të plotësuara. Kjo tregon se prindërit janë shumë të gatshëm të bashkëpunojnë me shkollën dhe rregullat përkatëse. Fëmijët u ndanë në grupe të vogla me ndërthurjen e Yllkave dhe Shqiponjave. Prania e prindërve vullnetare e bëri shumë të lehtë këtë ndarje. Në hyrje na priti Mrs. Lees, e cila i drejtoi fëmijët tek një sallë ku dhe lexoi librin **"The Incredible Book Eating Boy"**, që trajtonte më së miri rëndësinë e të lexuarit sa më shumë libra nga fëmijët. Më vonë fëmijët u ndanë në grupin e Yllkave dhe të Shqiponjave dhe u drejtuan në qendrat përkatesë për moshat e tyre. Gjatë vizitës, Yllkat u ndalën në këndin e lojrave ku u kënaqen shumë. Shqiponjat shkuan tek qendra e adolishentëve që quhet "Teen Space". Tek kjo qendër fëmijët tanë patën mundësinë të njihen me të rejat e fundit të teknologjisë. Disa fëmijë ishin të interesuar të përdorin kompjuterat për lojra elektronike, disa eksploruan për të gjetur libra të rinj dhe një pjesëkishin kuriozitet për krijimin e projekteve te ndryshme përmes programeve që kjo qendër ofron. Ky aktivitet mendojmë se ia arriti më së miri qëllimeve përkatëse.

1. Argëtimi i fëmijëve.
2. Njohja me mundësitë e reja që kjo librari e madhe ofron tek fëmijët për një të ardhme sa më të ndritur.
3. Praktikimi i të folurit në gjuhën shqipe dhe shpalosja e njohurive që kanë marrë në klasë. Kjo u realizua më së miri nga ndërthurja e komunikimit te fëmijëve me njeri-tjetrin dhe mësues-nxënës. Fëmijët tanë na nderuan si gjithmonë me sjelljen e tyre të shkëlqyer. Ky aktivitet nuk mund të ishte kaq i suksesshem pa ndihmën e prindërve vullnetare.**Ju faleminderit Prindër të dashur!**

Devonian Garden - Një tjetër ditë e mbushur plot argëtim ishte dhe dita te Devonian Garden. Atje fëmijët vizituan kopshtin botanik me pemë tropikale. Duke kaluar dhe vëzhguar pemët përreth, fëmijët mësuan në shqip jo vetëm llojet e tyre por dhe kujdesin që duhet të tregojmë për to. Më pas grupi ynë u ndal te një liqen i vogël në mes të kopshtit. Atje fëmijët panë peshqit dhe mësuan rreth tyre, pa harruar të bënin dhe fotografi. Duke ecur na zuri syri një piano të madhe ku kushdo mund të shkonte dhe të luante. Iu afruam dhe pamë një djalë të talentuar të luante shumë bukur. Drinori yne iu afrua pianos dhe shprehu dëshirën të luante një pjesë të Himnit të Flamurit. Të gjithë fëmijët u mblodhën rreth tij ta dëgjonin. Ishte një mrekulli të dëgjoje tingujt e himnit tonë Shqiptar në atë sallë të madhe. Nuk kishte gëzim më të madh për fëmijët, dhe sidomos për Drinorin. Të gjithë filluan ta përgëzonin Drinorin dhe i lanë detyrë të mësonte të gjithë melodinë dhe ta luante në Ditën e Flamurit. Pas Drinorit disa nga fëmijët tanë luajtën disa pjesë të vogla që dinin. Pasi mbaruam atje, shkuam te parku i lodrave ku fëmijët kaluan kohën derisa erdhën prindërit.

Të dashur prindër shihni sa jemi kënaqur!



Drinori n'a befasoi me Hymnin e Flamurit.

Janina luajti në piano disa këngë.

Kaitlyn përpiqet t'i mësojë Dr. Bejkos si bëhet shqiponja……..dhe ja më në fund rezultati!

Joni,Blerdi, Morena, Butrinti, Arsa, dëgjojnë me vëmendje mësimin për bimët tropikale sepse mësuese Zoica ka "harruar" Shqipen dhe ata duhet të përkthejnë për të

Informacion për shkollat e Albertës.

Edhe nëqoftëse sot femijët tanë nuk jane Akoma në shkollën e mesme, inromacioni I mëposhtëm do të n'a duhet një ditë. Këto janë websites ku gjendet informacion per bursat e studimit qe jepen për studentët qe aplikojnë për universitet:

- alis.alberta.ca
- www.cssd.ab.ca/students/grants
- Educationmatters.ca
- Calgaryfoundation.ca
- Scholarshipscanada.ca
- Scholartree.ca
- Scholarly.ca
- Yconic.ca
- Canlearn.ca
- Canadian-universities.net/scholarships

Femijet e Folese falenderojne BestBuy

Ju lutem na dergoni pyetjet tuaja lidhur me systemin arsimor (kerkesat, orari, aplikimet per universitet, rregjistrimet, bursat) në Alberta dhe ne do t'ju përgjigjemi në numrin e ardhshëm tëGazetes se Prindit.

Shqiptari Krenar

Të dashur prindër, të qenit krenar për vendin nga vijm ë është një virtyt që ne shqiptarët e manifestojmë më së miri. Le të pasojmë këtë ndjesi edhe tek fëmijët tanë duke lexuar e treguar histori për njerëzit më të shquar të kombit tonë. Një ndër to është edhe shkrimtari ynë i madh, Ismail Kadare.

Ismail Kadare lindi në 1936 në Gjirokastër ku dhe mbaroi shkollën e mesme. Studimet e larta i mbaroi në Universitetin e Tiranës, në degën e gjuhës dhe të letërsisë. Më pas shkoi në Moskë për studime. Ai është poet dhe prozator dhe një nga përfaqësuesit më të shquar të letërsisë shqiptare. Në vitin 1990 vendosi të largohet nga Shqipëria dhe të shpërngulet në Paris. Ismail Kadare është laureat i shumë çmimeve letrare-kombëtare dhe ndërkombëtare. Ismail Kadare me talentin e tij i paraqiti botës vlerat, historinë, traditat dhe kulturën tonë kombëtare. Në romanin "Kështjella", Kadare e merr subjektin nga qëndresa dhe luftrat e popullit shqiptar nën udheheqjen e Skenderbeut. Shkrimet e tij janë të shumta. Një ndër to është edhe poezia "Gjuha Shqipe". Në këtë poezi, ai thotë:

Kur panë se gjuhës
s'i hodhën dot prangat
Lëshuan drejt saj
Gjithfarë merimangash
Kjo gjuhë martire
Lehonë e përjetëshme
Që lindi mes dhëmbjesh
Art të pavdekshëm.

Edhe pse në moshë të thyer shkrimtari ynë i famshëm vazhdon të krijojë plot energji dhe ndiqet nga miliona lexues, i përkthyer në 45 gjuhë të botës. Atë që Skënderbeu e bëri me shpatë, Nënë Tereza e bëri me uratë, ndërsa Ismail Kadare po e bën me penë e me art. Një shprehje e bukur e Ismail Kadaresë që vlen shumë për ne që jetojmë larg vendit tonë është: "Ka gjithmonë kohë që njerëzit të bëjnë diçka për popullin e tyre." **Ne jemi krenar që jemi Shqiptarë, si Ismail Kadare!**

Prindër të nderuar, mësoni fëmijën tuaj me krenarinë shqiptare.